

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-50/14

**Prishtinë,
20 Korrik 2016**

Në çështjen juridike të:

**M.N. ,
Nabërgjan
Pejë**

Pala Ankuese

kundër.

**I.L. ,
Slavko Kruniq 16
Koriqan
Kragujec, Sërbi**

Paraqitësja e kërkesës- Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe, Krasimir Mazgalov, anëtar, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/C/100/2011(lënda është regjistruar në AKP me numrin 36252), i datës 23 shkurt 2011, pas shqyrtimit të mbajtur 20 Korrik 2016, morri këtë:

AKTGJYKIM

Hedhet si e papranueshme ankesa e M.N. e paraqitur kundër vendimit Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/100/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA36252), i datës 23 shkurt 2016.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 27 prill 2007, I.L. ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri posedimin e pronës së paluajtshme të ngastrës nr.566/1 në sipërfaqe prej 0.27.98 Ha që gjendet në Brestovik, komuna e Pejës. Ai ka shpjeguar se kjo pronë është e tij, dhe se është uzurpuar nga persona të panjohur, dhe se është humbur si rezultat i rrethanave në vitet 1998/1999 dhe se data e humbjes është 20 korrik 1999.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
 - Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-71611010-00102 i datës 1.7.2010 të lëshuar nga Zyra kadastrale e Komunës së Pejës. Me këtë certifikatë konstatohet se ngastra kadastrale 566/1 që gjendet në vendin e quajtur “Kosaç” në sipërfaqe prej 2798 m2 është evidentuar në emër të paraqitësit të kërkesës në cilësinë e pronarit.
 - Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë C.nr.697/07 i datës 4 shkurt 2008, me të cilën vërtetohet se palës ankuese i është vërtetuar e drejta e pronës së ngas.kadastrale që është objekt i kërkesës,
 - Me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac.nr.201/2008 i datës 22.6.2009, është prishur aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë C.nr.697/07 i datës 4 shkurt 2008.

- Me autorizimin Vr.nr.1828/1 i datës 8 shkurt 2007 konstatohet se paraqitësi i kërkesës ka autorizuar U.B. nga Peja që i njëjti të ndërmerr veprimet juridike për të përgatitur ngastrën kadastrale që është objekt i kërkesës për ndërtim.
 - Me autorizimin e paraqitësit të kërkesës Vr.nr.1828/1 i datës 28 maj 2007, të vërtetuar nga Administrata e qytetit për vetëqeverisje lokale në Kragujevc, theksohet se i autorizuari U.B. që ngastrën kadastrale që është objekt i kërkesës që mund ta shet dhe ta kalojë në emër të blerësit.
 - Me kontratën e datës 11.5.2007 Vr.nr.7443/07 të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Beograd theksohet se shitësi I.L. ia ka shitur ngastrën kadastrale U.B. që është objekt i kërkesës.
 - Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë, P.nr.245/08 i datës 19.5.2008, i pandehuri U.B. është shpallur fajtor sepse në autorizimin nr.1282 e datës 8.2.2007 e ka ndryshuar ashtu që në fund të tij ka shtuar fjalinë “se i njëjti përpos tjerash mund ta përkthejë dhe ta shesë tokën e paraqitësit të kërkesës” me ç’ rast ka kryer veprën penale të falsifikimit të dokumentit nga neni 332 par.3 të KPPK
 - Me parashtresën e palës ankuese të datës 22.1.2008 drejtuar Gjykatës Komunale në Pejë, ai ka tërhequr padinë ndaj U.B. meqenëse i njëjti ia ka kthyer atij paratë me të cilat ai e ka blerë pronën që është objekt i kërkesës.
 - Me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Pejë, C.nr.460/09 i datës 21.2.2012 konstatohet se paraqitësi i ankesës ka tërhequr padinë e paraqitur më datë 9.8.2009 kundër I.L. dhe U.B. nga Peja.
3. Prona e kërkuar e regjistruar sipas kërkesës KPA36252 është notifikuar me datë 5 qershor 2008 dhe 30 gusht 2010 me ç’ rast është konstatuar se kjo pronë nuk është e uzurpuar.
 4. Njësitë verifikues i AKP-ës ka verifikuar pozitivisht certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme të datës 1.7.2010.
 5. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronën e kërkuar, me vendimin e tij KKPK/D/C/100/2011 të datës 23 shkurt 2011, i ka pranuar paraqitësit të kërkesës të drejtën e pronës së paluajtshme të ngastrës kadastrale 566/1 në sipërfaqe prej 0.27.98 ha që gjendet në z.k. “Brestovik” Komuna e Pejës. Në

arsyetimin e këtij vendimi në par. 11 konstatohet se mbi bazën e fakteve të vërtetuara dhe provave të proceduara me pa mëdyshje është vërtetuar se paraqitësi i kërkesës ka të drejtën e pronës të paluajtshme që është objekt i kësaj kërkesë. Sikundër certifikata mbi pronën e paluajtshme e datës 1.7.2010 e lëshuar nga Zyra kadastrale në Pejë , konstatohet se paraqitësi i kërkesës është i regjistruar si në cilësinë e pronarit të pronës së paluajtshme. Sikundër kjo certifikatë edhe provat tjera janë verifikuar nga sekretaria Ekzekutive si të vlefshme dhe konsiderohen relevante.

6. Me,15.7.2011 i është dorëzuar paraqitëses së kërkesës vendimi i KKPK/D/C/100/2011 i datës 23 shkurt 2011.
7. Me 6.11.2013 M.N. ka paraqitur ankesë kundër këtij vendimi.
8. Ndërkaq pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës me dt.11 prill 2014
9. Në ankesë e tij ai thekson se vendimi ankimor është marrë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe me aplikim të gabuar të ligjit material, me propozim që vendimi i Komisionit të ndryshohet dhe ai të lirohet nga përgjegjësia. Më tej ai thekson se ka besuar që U.B. ka qenë në kontakte me paraqitësin e kërkesës lidhur me autorizimin e tij për ta shitur ngastrën kadastrale që është objekt i kërkesës dhe kështu ka besuar se e blenë këtë pronë si rezultat i marrëveshjeve korrekte, me ç' rast ia ka dhënë U.B. të hollat në shumë prej 13.500 € për t'ia dorëzuar paraqitësit të kërkesës.
10. Ka dëgjuar se motrat e paraqitësit të kërkesës – I.L. kanë pasur pretendime për pronën që është objekt i kërkesës. Pikërisht për këto shkaqe dhe arsye, ai ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale që ngastrën kadastrale që është objekt i kërkesës ta regjistrojë në emër të tij.
11. Paraqitësi i kërkesës ka dhënë përgjigje në ankesën e ankuesit me ç' rast ka theksuar që askujt nuk i ka dhënë autorizim që në emër dhe për llogari të tij ta shet pronën e theksuar. Autorizimin e datës 8.2.2007, U.B. e ka falsifikuar me ç' rast i njëjti është shpallur fajtor për veprën penale falsifikimi i dokumentit sipas aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë P.nr.245/2008 datë 13.5.2008. Pala përgjegjëse në ankesën më tej deklaroi se paraqitësi i ankesës nuk ka marrë pjesë në procedurën e gjykatës së shkallës së parë ndaj edhe ankesa e tij duhet të hidhet si e papranueshme.

Arsyetim ligjor:

Pa lejueshmëria e ankesës

12. Ankesa është e palejueshme (neni 13.3 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) pasi që pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën në shkallë të parë.
13. Kjo ngase sipas dispozitës së nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm Ligji nr. 03/L-079), pala mund të paraqes ankesë brenda (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës mbi vendimin e Komisionit për kërkesën. Po ashtu, sipas dispozitës së nenit 176.par 1 dhe 177.par 1 të LPK-ës parashikohet që e drejta për të paraqitur ankesë është e drejtë ekskluzive palëve të procedurës së shkallës së parë.
14. Prandaj sipas nenit 10.1” (neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079),parashikohet se palë në kërkesë dhe në procedurën e përafërta është “çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë [...], me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive.)
15. Nuk është kontestuese se pala ankuese nuk ka qenë palë dhe nuk ka marr pjesë në procedurën e shkallës së parë pranë KKPK-së. Pala ankuese nuk ka dhënë shpjegime dhe sqarime të drejta të plota dhe juridikisht të vlefshme për shkaqet të justifikueshme të arsyeshme që e kanë penguar dhe pamundësuar pjesëmarrjen në këtë procedurë e me qëllim që tani të pranohet si palë në këtë procedurë. Madje ai sipas padisë së tij Gjykata Komunale në Pejë ka marr aktgjykimin C.nr.697/07 i dt.04 shkurt 2008 ,i cili aktgjykim është anuluar nga Gjykata e Qarkut në Pejë Ac.nr.201/2008 i dt. 22 qershor 2009.Pas kësaj ankuesi duke tërhequr padinë, Gjykata Komunale në Pejë me aktvendimin C.nr460 i dt.21 shkurt 2012 ka konstatuar se ankesa është tërhequr.

16. Gjykata vëren se, njoftimi është kryer siç duhet. Ekipi i AKP-së ka vendosur-afishuar shenjen informuese në tri gjuhët – shqip, serbisht dhe anglisht në pronën e paluajtshme që është objekt i kërkesës.
17. Ankuesi nuk ka paraqitur shkaqe juridikisht të vlefshme të arsyeshme dhe të justifikueshme për ta informuar AKP-në për qëllimin e tij për të marrë pjesë në procedurë, gjë që detyrimisht është dashur të vepronte kështu. Kjo aq më tepër, ngase ankuesi ka paraqitur ankesë pas dy vjet pasi që është vendosur me vendimin ankimor. Pasi që ai nuk ka arsyetim se përse nuk kishte marrë pjesë në procedurën në shkallë të parë pranë AKP-së, ky dështim shkon në dëm të tij.
18. Pasi që ankesa është e palejueshme, Gjykatës Supreme nuk i lejohet që të vendos për meritat e ankesës përkatësisht vendimit.
19. Po kështu, ankuesit i mundon legjitimiteti materialo-juridik për të pasur cilësinë e palës në këtë çështje juridike kontestimore sipas nenit 77 par. 3 të LPK-së. Kjo pikërisht për arsye se „paraqitësi i ankesës dhe paraqitësi i kërkesës, sipas shkresave të lëndës (autorizimit të falsifikuar i datës 8.2.2007 nr. 1282 dhe para kontratës të datës 11.5.2007 si kontratës së dt.11.05 2007) rezulton se nuk janë pjesëmarrës e as që janë bartës të drejtave të detyrimeve nga ky raport civile-juridik.
20. Para kontrata e datës 7.2.2007 por edhe kontrata e dt. 11 maj 2007 e lidhur në mes të palës përgjegjëse në ankesë, në cilësinë e shitësit dhe U.B, në cilësinë e blerësit, nuk rezulton që është vërtetuar nga gjykata kompetente si dhe faktin që autorizimi i theksuar del të jetë i falsifikuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Komonale në Pejë, P.nr.245/08 i datës 19.5.2008,atëherë rezulton me pa mëdyshje dhe në mënyrë të sigurve se pretendimet ankimore të ankuesit janë të papranueshme, të pabazuara madje edhe bien ndesh me dispozitat e nenit 4 par. 2 të Ligjit për qarkullimin e paluajtshmërive “Gazeta zyrtare e RS. Nr.43/81, 24/85, 6/89, 30/89 dhe 40/89”. Sipas këtyre dispozitave ligjore forma e shkruar dhe nënshkrimi i palëve kontraktuese detyrimisht duhet të vërtetohet nga gjykata të cilët përfaqësojnë elemente konstituive pa të cilët ato veprime juridike janë juridikisht të pavlefshme.
21. Nga arsyet e paraqitura me pa mëdyshje rezulton se, jo vetë që pala ankuese nuk e ka informuar Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda 30 ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive sipas nenit 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-

079,por madje, atij i mundon legjitimiteti materialo-juridik për të pasur cilësinë e palës në këtë çështje juridike kontestimore sipas nenit 77 par. 3 të LPK-së. Kjo pikërisht për arsye se ,pala përgjegjëse në ankesë dhe pala ankuese nuk janë pjesëmarrës e as që janë bartës të drejtave të detyrimeve nga ky raport civile-juridik.

22. Prandaj, ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme (neni 13.3 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe me nenin. 195.1 nën paragrafi (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore).

Këshillë juridike

23. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me ankesë apo mjete të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetare Kolegji

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Krasimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it